

Neni 12

Versionet e tekstit në anglisht dhe frëngjisht të këtij protokollit janë njësoj autentike.

Teksti i mësipërm është teksti autentik i protokollit, i miratuar rregullisht nga konferenca e përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës gjatë sesionit të 90, të mbajtur në Gjenevë dhe deklaruar e mbyllur më 20 qershor 2002.

Në dëshmi të kësaj, ne i vumë firmat tona më 21.6.2002.

**L I G J**

Nr.9149, datë 30.10.2003

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8310, DATË 19.3.1998 "PËR  
SIGURINË NË AVIACIONIN CIVIL SHQIPTAR"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8310, datë 19.3.1998 "Për sigurinë në aviacionin civil shqiptar", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 "Përcaktimi i përgjegjësive" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

"Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil (DPAC) është autoriteti përgjegjës për sigurinë e aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë dhe për funksionimin e Komitetit të Sigurisë së Aviacionit Civil".

b) Pas shkronjës "g", shtohen shkronjat "gj", "h" dhe "i" me këtë përmbajtje:

"gj) DPAC-ja përcakton kriteret e punësimit në sektorin e sigurisë së aviacionit civil dhe miraton emërimin e punonjësve në këtë sektor.

h) DPAC-ja përgatit programet e trajnimit, të kualifikimit, të testimit dhe të certifikimit të punonjësve të sigurisë.

i) DPAC-ja, në marrëveshje me Ministrinë e Rendit Publik, përgatit programet e trajnimit, të kualifikimit, të testimit dhe të certifikimit të punonjësve të policisë dhe të doganave, për sigurinë në aeroport."

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11

Objekti i veprimtarisë së organit të Policisë së Shtetit, në përputhje me sigurinë në aviacionin civil, janë zbulimi, parandalimi dhe goditja e akteve kriminale, në veçanti të terrorizmit, të cilat mund të përbëjnë rrezik, si dhe parandalimi i incidenteve të rënda e i rasteve të jashtëzakonshme."

### Neni 3

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

### "Neni 12

Ministri i Rendit Publik është përgjegjës për përcaktimin e funksionit dhe të veprimtarisë së Policisë së Shtetit, për ruajtjen dhe sigurinë në aviacionin civil në aeroportet kombëtare dhe ndërkombëtare të vendit, nga aktet kriminale në përgjithësi dhe ato terroriste në veçanti dhe nga veprimet e tjera të paligjshme."

### Neni 4

Në nenin 13, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç. Evidentimi, zbulimi dhe ndalimi i personave në kërkim, që kanë kryer vepra penale, i personave që kanë kryer vepra terroriste ose dyshohen se i kanë kryer ato."

### Neni 5

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

### "Neni 16

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtarë të sigurisë dhe me shtetet e tjera, bashkërendojnë punën për sigurimin e aviacionit civil e të mjeteve fluturuese të tyre, për transport publik dhe jopublik, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe."

### Neni 6

Në nenin 21, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Punonjësit, që punojnë në aeroport, pajisen me leje hyrje vjetore ose të përkohshme, të prodhuar nga sektori i sigurisë së aeroportit. Format dhe modeli përcaktohen dhe miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil, me rekomandim të Komitetit të Sigurisë. Lista e këtyre punonjësve, para pajisjes me leje hyrje, kontrollohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë së aeroportit dhe miratohet nga DPCA-ja."

### Neni 7

Shkronja "b" e nenit 23 ndryshohet si më poshtë:

"b) kërkesat me shkrim të jenë të verifikuara edhe nga organi i Policisë së Shtetit, për të siguruar se ekzistojnë kushte për të lëshuar lejen."

### Neni 8

Në pikën 1 të nenit 24, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) personin përgjegjës, që lëshon lejen me vulën përkatëse."

### Neni 9

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 30

1. Strukturat e sigurisë së aeroportit, në përputhje me strukturat e organizimit veprimtarisë së tyre ligjore, ngarkohen për të kryer procesin e kontrollit të pasagjerëve, të mallrave dhe të postës, duke përfshirë atë të ekranizimit me rreze X dhe me dedektorë të ndryshëm.
2. Organi doganor, në përputhje me strukturat e organizimit të veprimtarisë së tij ligjore ngarkohet të kryejë kontrollin financiar (kontroll parash), si dhe bagazhet, mallrat dhe postën, hyrje dhe dalje."

Neni 10

Në nenin 34 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:  
"Brenda zonave tranzite ndalohet veprimtaria tregtare aeroportuale."

Neni 11

Neni 71 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 71  
**Financimi**

1. Për realizimin e infrastrukturës në aviacionin civil, me propozimin e DPAC-së, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit, në bashkëpunim me Ministrin e Financave, miraton tarifën për sigurinë në aviacionin civil.
2. Të ardhurat nga kjo tarifë ndahen në masën si më poshtë:
  - a) 25 për qind për DPAC-në;
  - b) 75 për qind për sektorin e sigurisë."

Neni 12

Në të gjithë tekstin e ligjit fjalët "Ministria e Brendshme" dhe "Ministria e Punëve Publike dhe Transporteve" bëhen "Ministria e Rendit Publik" dhe "Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit".

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4009, datë 18.11.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu